



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Bazuar në tre raportet e ekspertëve të kërkuara nga Trupi Gjykses në çështjen *Salih Mustafa*, ky Grup Gjykses doli në përfundimin se gjykatat vendore në Kosovë nuk japin një zgjidhje realiste për viktimat e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat në këtë çështje, në lidhje me kërkesat e tyre për zhdëmtim. Për këtë arsye, Trupi Gjykses vendosi se, në rast se do të ketë shpallje të fajësisë në këtë çështje gjyqësore, nuk do t'i referojë viktimat në gjykatat civile në Kosovë, por do të nxjerrë urdhër për zhdëmtim. Gjithashtu, Trupi Gjykses i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë në Kosovë që brenda datës 16 mars 2022 t'u përgjigjet pyetjeve lidhur me mënyrën sesi mund të zbatohet një urdhër zhdëmtimi i lëshuar prej Trupit Gjykses. Vendimi përkatës i Trupit Gjykses u parashtrua për protokollim më 4 shkurt dhe mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të DHSK-së.

Gjithashtu, më 4 shkurt, Zyra e Prokurorit të Specializuar mbylli paraqitjen e provave në procesin gjyqësor kundër Salih Mustafës. Po në të njëjtën ditë, Mbrojtja bëri me dije se synon të dorëzojë një mocion për të rrëzuar ndonjë ose të gjitha akuzat në Aktakuzë (rregulla 130). Ky mocion do të dorëzohet më 15 shkurt 2022, dhe afati i ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave për t'iu përgjigjur është data 21 shkurt 2022. Trupi Gjykses synon të nxjerrë vendim lidhur me këtë mocion midis datave 23 dhe 25 shkurt 2022. Deri në momentin që do vendoset lidhur me këtë mocion, gjykimi nuk mund të kalojë në fazën tjetër, e cila është faza e paraqitjes së provave prej mbrojtëses së viktimave dhe Mbrojtjes.

Në lidhje me çështjen gjyqësore *Gucati dhe Haradinaj*, Trupi Gjykses II mbylli fazën e paraqitjes së provave të procesit më 3 shkurt, pas mbylljes së paraqitjes së provave prej Mbrojtjes më 2 shkurt. Trupi Gjykses më tej urdhëroi Mbrojtjen dhe Prokurorinë





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°5/2022

Hagë, 10/02/2022

të dorëzojnë dosjet e tyre gjyqësore përfundimtare brenda datës 3 mars dhe planifikoi që deklaratat përmbyllëse të mbahen midis datave 14 dhe 18 mars 2022.

Pasditën e 4 shkurtit, u mbajt seancë e procedurës paraprake në *çështjen Thaçi dhe të tjerë*, në të cilën u diskutuan aspekte lidhur me vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarve, procesin e nxjerrjes së materialeve dhe ecurinë e hetimeve.

Seanca e ardhshme e procedurës paraprake në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për datën 24 mars në orën 14:30.

Seanca e ardhshme për ecurinë e çështjes gjyqësore *Shala* është planifikuar për datën 4 mars në orën 14:30.

Ndër lajme të tjera: ekipi i programit për komunikim dhe ndërgjegjësim i DHSK-së të martën mbajti një ligjëratë dhe diskutime me nxënësit e shkollës së mesme nga Ferizaj. Po ashtu ditën e sotme, u mbajt një aktivitet i ngjashëm me banorët e Kosovës Veriore gjatë të cilit pjesëmarrësve iu dhanë informacione bazë lidhur me gjykatën dhe proceset e saj si dhe iu përgjigjën pyetjeve të tyre.

Që prej vitit 2018, Dhomat e Specializuara kanë organizuar 102 aktivitete të ngjashme ndërgjegjësuere në të gjithë Kosovën, qoftë përmes internetit ose me prani fizike, me qytetarë, të rinj, shoqërinë civile dhe të tjerë për të dhënë informacione rreth gjykatës, për të dëgjuar komentet dhe shqetësimet e qytetarëve si dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre.

Pyetje nga gazetarët

Një gazetar kërkoi një koment për deklaratat e fundit të Mbrojtjes së Thaçit. Zëdhënësja e DHSK-së, znj. Griep u përgjigj se nuk do të komentojë.

